



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROPOZIM

RREGULLORE
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Lipjan, 2022

Në bazë të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në bazë të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 dhe 20, të Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ të miratojë këtë:

PROPOZIM

RREGULLORE
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË LIPJANIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës, dhe procedura për ndarjen e bursave për studentë, të cilët studiojnë në Institucionet e edukimit të lartë arsimor të Republikës së Kosovës.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Komuna e Lipjanit, varësisht nga mjetet financiare që ka në dispozicion, ndanë bursa për studentë të Komunës së Lipjanit.
2. Bursat ndahen për periudhën kohore nga 1 tetori deri më 30 shtator të vitit vijues akademik-shkollor.

Neni 3

Përkufizimet

1. Përkufizimet e kësaj Rregulloreje janë:
 - 1.1. **Bursë** - Nënkupton ndihmën e dhënë në mjete financiare pa kthim nga Komuna e Lipjanit për studentët e nivelit bachelor nga Komuna Lipjanit që studiojnë në Institucionet e edukimit të lartë arsimor të Republikës së Kosovës.
 - 1.2. **DKA** - Nënkupton Drejtorin e Arsimit të Komunës së Lipjanit.
 - 1.3. **Thirrja publike** - Do të thotë konkursi publik për ndarjen e bursave për studentë që shpallet nga DKA-ja konformë dispozitave të kësaj Rregullore dhe dispozitave tjera përkatëse.

1.4. Komision vlerësues - Nënkupton komisionin e formuar me vendim të Kryetarit të Komunës i cili merret me shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të bursave.

1.5. Komision i ankesave - Nënkupton komisionin e formuar me vendim të Kryetarit të Komunës i cili merret me shqyrtimin e ankesave që parashtrohen nga studentët ndaj shpalljes së listes preliminare të përfituesve të bursave.

1.6. Komisioni për caktimin e numrit të bursave në fusha studimi - është komision që formohet nga DKA-ja.

Neni 4 **Përfituesit e bursës**

1. Të gjithë studentët që janë banorë të Komunës së Lipjanit, pa dallime etnike, gjinore, racore, fetare, sociale dhe politike, që janë të regjistruar në Institucionet e edukimit të lartë arsimor të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studime pasuniversitare - master dhe doktoraturë, kanë të drejtë të aplikojn për marrjen e bursës për studime.

2. Studentët që kanë të drejtë të aplikojnë për përfitim të bursës duhet të jenë të regjistruar nga viti i dytë e tutje.

Neni 5 **Përfituesit e bursës me automatizëm**

1. Fëmijët e Dëshmorëve që studiojnë në Institucionet e edukimit të lartë arsimor të Republikës së Kosovës, bursën e përfitojnë me automatizëm çdo herë kur Komuna shpallë thirrje publike për ndarjen e bursave për studentë pavarësisht se a është e përcaktuar fusha studimit apo jo në thirrjen publike.

2. Për të fituar të drejtën sipas paragrafit 1 të këtij neni, studentët duhet të aplikojnë me dokumentacionin e kërkuar sipas thirrjes publike të shpallur nga Komuna.

Neni 6 **Numri i bursave**

Para shpalljes publike për ndarjen e bursave, Kryetari i Komunës në përputhje me ndarjet buxhetore me akt të veçantë përcakton numrin e përgjithshëm të bursave dhe shumën financiare për një bursë që ndahen për një vit akademik - shkollor.

Neni 7 **Formimi dhe përbërja e komisionit vlerësues**

1. Bursat për studentë do të ndahen nga komisioni vlerësues i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.

2. Komisioni vlerësues do të jetë i përbërë nga 3 (tre) anëtarë që duhet të jenë shërbyes civil të administratës komunale, 2 (dy) anëtarë nga Drejtorati i Arsimit, 1 (një) anëtarë nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

3. Punët teknike administrative të nevojshme për komisionin, pranimi i kërkesave/aplikacioneve, formulimin e vendimeve apo kontratave për përfituesit do të kryhen nga Drejtorati i Arsimit.

Neni 8

Shpallja e thirrjes publike

1. Drejtorati i Arsimit shpallë thirrjen publike për ndarjen e bursave. Thirrja publike duhet të jetë e shpallur në web faqen zyrtare të Komunës, dhe në tabelën e shpalljeve dhe duhet të jetë e hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.
2. Në thirrjen publike për aplikim për bursë duhet të përcaktohet dokumentacioni i kërkuar dhe informatat tjera të nevojshme.

Neni 9

Komisioni për caktimin e numrit të bursave në fusha studimi

1. DKA-ja, para shpalljes së thirrjes publike për bursa, formon një Komision për caktimin e numrit të bursave në fusha studimi.
2. Komisioni për caktimin e numrit të bursave në fusha studimi do të ketë tre anëtarë. Anëtarët e këtij komisioni mund të jenë zyrtarë të DKA-së dhe puntorë arsimor.
3. Komisioni për caktimin e numrit të bursave në fusha studimi ka për detyrë të përcaktoj ndarjen e numrit të bursave në fusha të caktuara studimi duke marr në konsideratë kërkesat e Komunës për fusha specifike të profesionistëve.
4. Po ashtu Komisioni për caktimin e numrit të bursave në fusha studimi duhet të vlerësojë dhe përcaktoj drejtimet deficitare të cilave mund t'i ipet përparësi sipas kriterëve të kësaj Rregullore. Komisioni duhet t'i rekomandoj DKA-së që në thirrjen publike për aplikim të përcakton drejtimet deficitare dhe ato duhet të precizohen saktësisht në thirrje.
5. Vendimet e këtij komisioni mirren me shumicë të thjeshtë.
6. Mandati i Komisionit për caktimin e numrit të bursave në fusha studimi, do të jetë vetëm për kryerjen e detyrave para shpalljes së thirrjes për bursa për një vit akademik.

II. VLERËSIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE

Neni 10

Kushtet dhe kriteret

1. Për realizimin e të drejtës së bursës kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:
 - 1.1. Të jenë banorë rezident të Komunës së Lipjanit,
 - 1.2. Të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin ipet bursa (vërtetimi i regjistrimit të semestrit të radhës për vitin akademik të studimeve për të cilin ipet bursa),

1.3. Të kenë certifikatën e notave (në certifikaten e notave duhet të jetë e precizuar nota mesatare),

1.4. Studenti/ja, gjatë aplikimit duhet të dorëzoj një deklaratë me shkrim, me të cilën deklaron se nuk është përfitues i ndonjë burse tjetër për vitin e njëjtë akademik për të cilën ipet bursa.

1.5. Studentët të cilët kan përseritë cilin do vit të studimeve, nuk kanë të drejtë të përfitimit të bursës.

Neni 11

Kriteret për përfitimin e bursës

1. Të gjithë studentët, pa dallime, që studiojnë në Institucionet e edukimit të lartë arsimor të Republikës së Kosovës e që kanë aplikuar për përfitimin e bursës do të vlerësohen për sukseset e arritura në mësimet e studimeve të vitit paraprak me pikë si në vijim:

- 1.1. Studenti/ja me notë mesatare 9 deri në 10, vlerësohet me 30 pikë,
- 1.2. Studenti/ja me notë mesatare 8 deri në 8.99, vlerësohet me 20 pikë,
- 1.3. Studenti/ja me notë mesatare 7 deri në 7.99, vlerësohet me 10 pikë,
- 1.4. Studenti/ja me notë mesatare 6 deri në 6.99, vlerësohet me 5 pikë,
- 1.5. Studenti/ja me studime në drejtimet deficitare vlerësohet me 15 pikë,
- 1.6. Studenti/ja me nevoja të veçanta vlerësohet me 5 pikë,
- 1.7. Studenti/ja fëmijë i martirëve, veteranëve, invalidëve të luftës vlerësohet me 5 pikë,
- 1.8. Studenti/ja që i përketë komunitetit jo shumicë vlerësohet me 5 pikë,
- 1.9. Studenti/ja me asistencë sociale vlerësohet me 5 pikë.

2. Studentët që kanë pikë të barabarta, përparësi në renditjen e listës të shpallur nga komisioni vlerësues për ndarjen e bursave, do t'i ipet studentëve që kanë notën mesatare më të lartë.

Neni 12

Detyrat e komisionit vlerësues

Komisioni vlerësues pas skadimit të afatit të aplikimit do të bëj vlerësimin e të gjitha aplikacioneve. Gjatë procedurës së vlerësimit të aplikacioneve, komisioni do të përcaktojë metodën e punës dhe mënyrën e seleksionimit të aplikacioneve, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 13

Hartimi dhe publikimi i listës së përfituesve të bursës

1. Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të aplikacioneve, komisioni për ndarjen e bursave harton listën e përgjithshme preliminare të kandidatëve përfitues të bursës.

2. Lista e përfituesëve duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e studentit/es, universitetin apo kolegjin ku studion, fushën e studimit, dhe pikët e fituara.
3. Lista preliminare e përfituesve shpallet në web faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.

Neni 14

E drejta e ankesës

1. Shqyrtimi i ankesave të studentëve pas publikimit të listës preliminare bëhet nga komisioni i ankesave i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.
2. Kundër vendimit për shpalljen e listës preliminare të përfituesve të bursave nga komisioni vlerësues për ndarjen e bursave, lejohet ankesa e cila i drejtohet komisionit të ankesave nëpërmjet Drejtoratit për Arsim.
3. Ankesa ushtrohet në afat prej pesë (5) ditëve nga dita e shpalljes së listës së përfituesve nga ana e komisionit vlerësues.
4. Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në afat prej 15 ditësh duhet të shqyrtojë dhe të vendos lidhur me ankesat e ushtruara.
5. Vendimi i komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurë administrative.
6. Mandati i komisionit të ankesave do të jetë vetëm për kryerjen e detyrave sipas thirrjes publike për ndarjen e bursave për një vit akademik-shkollor.

Neni 15

Nënshkrimi i aktit për ndarjen e bursës

1. Kryetari i Komunës pas përfundimit të procedurave të ankesave nënshkruan vendimin për secilin përfitues për marrjen e bursës sipas listës përfundimtare të shpallur nga Komisioni vlerësues, në bazë të aplikacioneve individuale të studentëve.
2. Nëse ndonjëri nga përfituesit e bursës hjekë dorë nga përfitimi i bursës për arsye të ndryshme, atëherë përfituesi i bursës do të jetë kandidati/ja që është në radhë sipas listës.

Neni 16

Procedurat e pagesës

1. Mjetet financiare do të alokohen gjatë vitit fiskal në xhirollogaritë bankare të përfituesve, në bankën të cilën studenti/ja e ka zgjedhur.
2. Drejtoratet kompetente për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Arsim janë të obliguar të kujdesen për alokimin dhe zotimin e mjeteve të cekura më lartë brenda afateve të përcaktuara kohore.

Neni 17

Përgjegjësia për zbatim

Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregullore është Drejtorati për Arsim në Komunën e Lipjanit.

III DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 18 Dispozitat kalimtare

Çdo dispozitë e kësaj Rregulloreje që bie ndesh me ligjet në fuqi epërsi do të kenë për zbatim dispozitat ligjore.

Neni 19 Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare elektronike të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregulloreja për ndarjen e bursave për studentë, 15Nr.670-19941 e datës 29.05.2020 si dhe Rregullorja 15Nr.670-19941 e datës 29.05.2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë 15Nr.670-47372 e datës 30.09.2020.

A r s y e t i m

Baza ligjore për të miratuar këtë Propozim Rregullore është përcaktuar në bazë të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 dhe 20, të Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021.

Me Vendim të Kryetarit të Komunës është formuar grupi punues për hartimin e Propozim-Rregullores.

Kjo Propozim Rregullore konformë dispozitave ligjore ka qenë në konsultim me publikun 30 ditë dhe brenda kësaj periode është organizuar edhe një debat publik me qytetarët e Komunës së Lipjanit.

Propozim-Rregullorja përmban gjithsej III kapituj dhe 19 nene.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e Propozim Rregullores.

1Nr. 1-01/01-19178
Lipjan; më 13.04.2022

